

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6753
E mërkurë, 9 nëntor 2022
çmimi 0.40

Muhamet Mavraj: Ose krah me ShBA-të ose të dështuar



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI I KA PRITUR NË ZYRË LIDERËT E PARTIVE OPOZITARE,
MEMLI KRASNIQI, LUMIR ABDIXHIKU DHE RAMUSH HARADINAJ

LIDERËT E OPOZITËS I KËRKOJNË KURTIT KOORDINIM ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

Haradinaj pasi e lëshoi takimin me Kurtin: Nuk isha i interesuar të dëgjoja ligjëratat



Udhëheqësit e partive politike opozitare i kanë kërkuar të martën kryeministrit Albin Kurti që t'i bashkërendojë veprimet me aleatët perëndimorë për tejkalimin e krizës në veri pas tërheqjes së punonjësve serbë nga të gjitha

institucionet. Liderët e opozitës kanë theksuar se nuk kanë parë ndonjë plan të qeverisë për zgjidhjen e gjendjes së re të krijuar dhe gatishmëri për bashkërendim të plotë të veprimeve me aleatët perëndimorë

KURTI: REGJISTRIMI I POPULLSISË, NJË PREJ NDËRMARRJEVE MË TË RËNDËSISHME INSTITUCIONALE



ABONIMI NJËVJEÇAR NË PARKINGUN NËNTOKËSOR TË PRISHTINËS PRITET TË JETË 2 500 EURO

RENOVA PUTZ

Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.PK.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



KOSOVA DHE FRANCA, MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

GJYKATA I LIRON NGA AKUZA KATËR ISH-MINISTRA TË QEVERISË SË KOSOVËS

PYET EDITA TAHIRI: NËSE JO ME AMERIKANËT, ATËHERË ME KË KOORDINOHET KURTI?

EKONOMI



MBI 60 MIJË VIZITORË NË HOTELET E KOSOVËS GJATË GUSHTIT, SHUMICA TË HUAJ

SËRISH ZGJATEN PËR 30 DITË MASAT EMERGJENTE TË ENERGISË ELEKTRIKE

SPORT



KOSOVA, BINDËSE NDAJ GJIBALTARIT

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Kryeministri suedez synon ta bindë Erdoganin për anëtarësim në NATO

STOKHOLM, 8 NËNTOR - Kryeministri i Suedisë, Ulf Kristersson, pritet të takohet me presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan, në Ankara të martën, në një tentim për ta bindur Turqinë t'i japë fund kundërshtimit për anëtarësimin e Suedisë në NATO.

Pasi Rusia e nisi pushtimin e Ukrainës, Suedia dhe Finlanda i dhanë fund politikës së tyre të kahershme të neutralitetit dhe aplikuan për anëtarësim në aleancën ushtarake. Por, Turqia e ka penguar ratifikimin e kërkesës së tyre, duke i akuzuar se po strehojnë militantë të jashtëligjshëm kurdë.

Erdogan, i cili synon të rizgjidhet president vitin e ardhshëm, është në një pozitë të mirë, pasi e ka bindur homologun e tij rus, Vladimir Putin, të mos i bllokojë më eksportet e drithërave nga Ukraina. Ai dhe Kristersson do të takohen në pallatin presidencial në orën 15:15, pastaj do të mbajnë konferencë për medie.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e vizitoi Ankaranë javën e kaluar për ta shtyrë përpara kërkesën e Suedisë dhe Finlandës. "Anëtarësimi i tyre do ta bëjë aleancën tonë më të fuqishme dhe popujt tanë më të sigurt", tha ai, duke shtuar se anëtarësimi i Suedisë dhe Finlandës në NATO "do t'ia dërgonte Rusisë një mesazh të qartë".

Stoltenbergu theksoi se dy vendet kishin pranuar t'i bëjnë disa koncesione ndaj Turqisë qysh në qershor, përfshirë këtu kërkesën e Turqisë që "të dyshuarit për terrorizëm" të

deportohen ose ekstradohen.

"Optimizëm i matur"

Në një shkrim për gazetën suedeze "Aftonbladet", të hënën këshilltari i Erdoganit, Fahrettin Altun, e shprehi "optimizmin e matur" që qeveria e re e krahut të djathtë në Stokholm do të ndërmerre "hapa konkretë" për t'i adresuar shqetësimet e Turqisë. Turqia e akuzon Suedinë, në veçanti, për qëndrime të lehta ndaj Partisë militante të Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) dhe degës së saj siriane, Njësitë e Mbrojtjes së Popullit (YPG).

Ankaraja ka thënë se në qershor u kishte dërguar Suedisë dhe Finlandës një listë të njerëzve për ekstradim. Që nga atëherë Stokholmi e ka autorizuar një ekstradim për mashtrim. Edhe Suedia, edhe Finlanda thonë se vendimet për ekstradime bëhen nga gjykatat.

PKK-ja është futur në listë të zezë nga Ankaraja dhe shumica e aleateve të saj perëndimore. Por, YPG-ja ka qenë kyçe në aleancën ushtarake të drejtuar nga ShBA-ja për luftimin e grupit të Shtetit Islamik (IS) në Siri.

Përderisa Suedia në të kaluarën ka shprehur përkrahje për YPG-në dhe kahun e tyre politik, qeveria e Kristerssonit duket se po distancohet nga ta.

"Ka një lidhje shumë të ngushtë mes këtyre organizatave dhe PKK-së, që është një organizatë terroriste e listuar nga Bashkimi Evropian", tha ministri i Punëve të Jashtme, Tobias Billstrom, të shtunën.



Karta e zgjerimit të NATO-s

Në tetor Billstrom kishte thënë për agjencinë e lajmeve AFP se ishte i bindur se Suedia mund t'i realizojë kërkesat e Turqisë. Ndërsa presidenti finlandez Sauli Niinisto u tha gazetarëve të hënën se ai priste që anëtarësimi në NATO "të ndodhë në një afat të arsyeshëm kohor". Megjithatë, disa analistë besojnë se zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të Turqisë në qershor të vitit 2023 mund t'i vonojnë kërkesat e vendeve nordike. "Turqia do ta ratifikojë anëtarësimin e tyre kur të besojë se është momenti më i mirë për ta luajtur atë kartë", thotë Ilke Toygur, profesore e gjeopolitikës evropiane në Universitetin "Carlos III" në

Madrid të Spanjës. "Unë kam përshtypjen se shumë vende në NATO tashmë supozojnë se zgjerimi do të ndodhë vitin tjetër, madje ndoshta edhe në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm", tha ajo për AFP.

"Supozohet se Turqia është gjithashtu duke tentuar të negociojë për gjëra të tjera. Mund të bëhet fjalë për [avionët] F16. Mund të bëhet fjalë për marrëdhëniet e tyre me Rusinë". Senatorë amerikanë kanë kërcënuar me bllokimin e shitjes së avionëve luftarakë F16 për Ankaranë nëse Turqia nuk u jep fund mosmarrëveshjeve kufitare detare me Greqinë.

Turqia, që synon të mbajë marrëdhënie të mira edhe me Ukrainën, edhe me Rusinë, nuk

u është bashkuar sanksioneve perëndimore ndaj Moskës dhe ka marrë një sistem rus të mbrojtjes raketore, ndërkohë që e furnizon Kievin me dronë luftarakë. "Mbetet të shihet nëse Erdogani mendon se ai ka mjaftueshëm shenja vullneti të mirë nga Suedia dhe nëse është në interesin e tij politik dhe ushtarak ta shpallë fitoren, ose nëse mendon që vazhdimi në linjën e deritanishme do t'i shërbejë më mirë fushatës së tij elektorale", tha një burim diplomatik evropian.

Ka ende "mundësi të arsyeshme" që Turqia t'i ratifikojë kërkesat për anëtarësim në NATO para zgjedhjeve të vitit 2023, tha burimi.

Zelensky bën thirrje që amerikanët ta vazhdojnë mbështetjen për Ukrainën

KIEV, 8 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky bëri thirrje që Uashingtoni të qëndrojë i bashkuar teksa janë ngritur pyetje rreth mbështetjes amerikane për shtetin e tij pas zgjedhjeve të mesmandatit që do të përcaktojnë se kush e kontrollon Kongresin amerikan. "Ju bëj thirrje të qëndroni të bashkuar, sikurse tani, deri në ditën kur ne të gjithë të dëgjojmë ato fjalë të cilat i ëndërojmë... derisa të dëgjojmë se paqja më në fund është rivendosur. Demokracitë nuk duhet të ndalen në rrugën e tyre për fitore", ka thënë ai.

Presidenti amerikan Joe Biden ka qenë aleat kyç i Kievit në furnizimet me armë dhe ndihma financiare pas pushtimit rus të Ukrainës.

Zgjedhjet në ShBA po mbahen për kontrollin e Dhomës së

Përfaqësuesve dhe të Senatit amerikan. Nëse demokratët e Bidenit humbin zgjedhjet, atëherë mund të vihet në pikëpyetje mbështetja e fuqishme e ShBA-së për Kievin. "Si në çdo shoqëri demokratike, ukrainasit kanë mendime të ndryshme për jetën dhe politikën. Si në rastin e viteve të kaluara, ne kemi qenë të ndarë dhe kemi pasur mëdyshje nëse do të mund të bashkohemi", ka deklaruar Zelensky, duke theksuar se Rusia vendosi ta shkatërojë lirinë e tyre dhe ta zhdukë Ukrainën nga faqja e dheut. "Ne menjëherë u bashkuam", shtoi ai.

Kongresi amerikan ka ndarë 40 miliardë dollarë për Ukrainën në maj si pjesë e mbështetjes për ushtrinë ukrainase dhe gjatë kësaj jave Kievi pranoi nga Uashingtoni më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore.



Muhamet Mavraj: Ose krah me ShBA-të ose të dështuar

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë.

Ish-udhëheqësi i Lëvizjes Studentore i '97-s ka thënë se drejtuesit aktualë të shtetit janë duke i kthyer të gjithë kundër, kurse Serbinë janë duke e vënë në një pozitë të favorshme ndërkombëtare.

Mavraj ka thënë se drejtuesit e shtetit më shumë janë duke e dashur vetveten sesa vatanin. Ai ka shtuar se pushtetarët e sotëm as nuk duhet të japin dorëheqje dhe as të shkarkohen pa u ngi. "Gjërat ngelin gjithmonë të thjeshta për Kosovën: ose krah me ShBA-të ose të dështuar. Strategjia e komplikimeve dhe zvarritjeve destruktive e ka bërë top Serbinë, e ka faktorizuar mu në periudhën më të errët të prestigjit të saj ndërkombëtar që nga paslufta", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

Shkrimi i plotë i Mavrajt në "Facebook":

Përshëndetje miq!

Nuk kam diçka të re për t'ju thënë.

Kemi fol moti për indiferencën humane në krye të shtetit dhe institucioneve të ndërtuara me çmim të lartë.

Asgjë e re në frontin e Stanit. Ata e duan veten dhe ato që i kanë zotëruar deri tani, jo vatanin. Gjërat ngelin gjithmonë të thjeshta për Kosovën: ose krah me ShBA-të ose të dështuar. Strategjia e komplikimeve dhe zvarritjeve destruktive e ka bërë top Serbinë, e ka faktorizuar mu në periudhën më të errët të prestigjit të saj ndërkombëtar që nga paslufta. Kosova është problem jo vetëm i Kosovës, jo vetëm i shqiptarëve, jo vetëm ndërfqinjësor, jo vetëm ballkanik dhe jo vetëm evropian. Është edhe amerikan. Është rrotulluar bota për Kosovën në vitin 1999. Rilindja dhe njohja e saj ndërkombëtare u bë me miqtë amerikanë e britanikë, në plan të parë. Sa për Evropën, atëherë do të zhdukeshim. Edhe sot, madje! Stani me narcisoidet që rrinë para pasqyrave duke u kënaqur me retorikën e të prapmeve ku janë përbashkuar, të gjithë po na i kthen kundër. Brenda katastrofë, jashtë katastrofë. Hajt zeko hajt, mirë e keni ju! Jo doreheqje, jo shkarkime, pa u ngi mire jo kurre!



Kurti: Regjistrimi i popullsisë, një prej ndërmarrjeve më të rëndësishme institucionale



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në konferencën hapëse të Javës së Regjistrimit të Popullsisë, organizuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës në kuadër të ZKM-së, mbështetur nga UNFPA-Zyra në Kosovë. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se regjistrimi i popullsisë,

ekonomive familjare dhe i banesave përbën një prej ndërmarrjeve më të rëndësishme institucionale në vendin tonë. "Të dhënat mbi madhësinë, shpërndarjen dhe përbërjen e popullsisë, kushtet e jetesës e niveli i edukimit, janë bilanci empirik i së tashmes dhe baza e politikave për të ardhmen. Ato u mundësojnë të gjithë shfrytëzuesve të të dhënave, veçanërisht vendimmarrësve në

nivelin lokal e qendror, por edhe donatorëve e investuesve të tjerë - orientimin dhe targetimin e politikave dhe shërbimeve më të mira për qytetarët", u shpreh kryeministri Kurti.

Të dhënat, u shpreh kryeministri, na ndihmojnë të sigurojmë nivel më të lartë të transparencës dhe të llogaridhënies dhe se ato janë pika referuese për një planifikim afatgjatë dhe parashikime të zhvillimeve të rëndësishme socio-

ekonomike.

Më tej, shtoi ai, të dhënat flasin për një rritje ekonomike historike në vendin tonë për vitin që shkoi me 10.7 për qind të bruto-produktit vendor, ndërsa në çerekun e parë të këtij viti kemi rritje 4 për qind të bruto-produktit vendor. "Rritjen ekonomike po e shpërndajmë te qytetarët nëpërmjet masave e politikave të informuara nga të dhënat", ka deklaruar kryeministri. Kurti ka folur për masat që janë

marrë për t'i mbështetur qytetarët dhe bizneset si dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, në vlerë 3 miliardë e 212 milionë euro. "Janë të dhënat ato që do ta udhëzojnë ekzekutimin e këtij buxheti, bashkë me angazhimin e qeverisë për t'i avancuar të gjitha aspektet që ndikojnë në jetën e qytetarëve në Republikën e Kosovës", ka deklaruar kryeministri Kurti.



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI I KA PRITUR NË ZYRË LIDERËT E PARTIVE OPOZITARE, MEMLI KRASNIQI, LUMIR ABDIXHIKU DHE RAMUSH HARADINAJ

Liderët e opozitës i kërkojnë Kurtit koordinim me partnerët ndërkombëtarë

- Haradinaj pasi e lëshoi takimin me Kurtin: Nuk isha i interesuar të dëgjoja ligjërrata

Udhëheqësit e partive politike opozitare i kanë kërkuar të martën kryeministrit Albin Kurti që t'i bashkërendojë veprimet me aleatët perëndimorë për tejkalimin e krizës në veri pas tërheqjes së punonjësve serbë nga të gjitha institucionet vendase për shkak të mospajtimeve me vendimin e qeverisë për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia. Liderët e opozitës kanë theksuar se nuk kanë parë ndonjë plan të qeverisë për zgjidhjen e gjendjes së re të krijuar dhe gatishmëri për bashkërendim të plotë me aleatët perëndimorë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka takuar të martën në zyrën e tij liderët e partive opozitare, Memli Krasniqin,

Lumir Abdixhikun dhe Ramush Haradinajn. Në këtë takim u diskutua për situatën aktuale në Republikën e Kosovës, sidomos pas ngjarjeve në veri të Mitrovicës. Sipas njoftimit të qeverisë, kryeministri Kurti në

këtë takim ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, paqes dhe sigurisë, dhe se është në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim. "U theksua aleanca me partnerët ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian e NATO-n, dhe komunikimi e bashkërendimi në shërbim të paqes e në ruajtje të rendit publik dhe sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës", theksohet në njoftim. Bëhet me dije se kryeministri Kurti i falënderoi liderët e partive opozitare që iu përgjigjen pozitivisht ftesës për takim dhe

diskutim. "Krerët opozitarë shprehën mbështetjen ndaj qeverisë për respektimin e ligjshmërisë në të gjithë Republikën e Kosovës", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Për këtë takim janë deklaruar edhe liderët e partive opozitare. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, i cili në këtë takim ishte i shoqëruar nga kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka thënë se ka përsëritur qëndrimin e PDK-së se kjo situatë kërkon veprime të përgjegjshme politike dhe koordinim të ngushtë me partnerët tanë kryesorë ndërkombëtarë, për ta siguruar ruajtjen e sovranitetit dhe shtetësinë në çdo centimetër të

Republikës së Kosovës. Krasniqi ka thënë se nga ky takim nuk doli shumë i sigurt që kryeministri dhe qeveria janë duke ditur të dalin suksesshëm nga kjo rrugë, duke ruajtur tërësinë e Kosovës dhe funksionimin e shtetit. "Mendoj që sot e kemi një situatë të re e cila ka mundur të shmanget. Papjekuria në disa veprime dhe mungesa e koordinimit të duhur me aleatët kryesorë të Kosovës duket se ka sjellë një momentum që ka mundur të shmanget. Sidoqoftë, ne jemi këtu ku jemi dhe është përgjegjësi e qeverisë para së gjithash, por është obligim i të gjithëve që Kosovën ta vendosim si prioritet para çfarëdo lloj konsiderate tjetër politike, partiake që mund ta

Pyet Edita Tahiri: Nëse jo me amerikanët, atëherë me kë koordinohet Kurti?

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka komentuar takimin e së martës të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me liderët opozitarë. Ajo në "Facebook" ka shprehur shqetësimin e saj në lidhje me

moskoordinimin e kryeministrit Kurti me ShBA-në për situatën në veri. "Takimi mes kryeministrit dhe opozitës nuk rezultoi në unitet, por në ndarje rreth rëndësisë së koordinimit me ShBA-në. Opozita u shpreh se është pro për ShBA-në, ndërsa kryeministri Kurti

vazhdoi të jetë kundër koordinimit me ShBA-në. Një gjë duket absurde, Kurti thotë në medie se koordinohet me aleatët, mirëpo pyetja është: nëse nuk koordinohet me amerikanët, atëherë me kë koordinohet Kurti?", ka shkruar Tahiri.



kemi”, ka deklaruar Krasniqi. Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës duhet t’i ndërmarrë veprimet që i takojnë për vazhdimin e ushtrimit të sovranitetit juridik, për ruajtjen e rendit publik dhe për ofrimin e shërbimeve bazike në katër komunitat e pjesës veriore të vendit. “Ne diskutuam rreth asaj se si është situata, si ka ardhur deri këtu, por unë isha më shumë i interesuar të dëgjoj për planet e ardhshme të qeverisë për ta menaxhuar këtë situatë. Nuk mund të them se dola me ndonjë siguri të madhe se qeveria e di se në çfarë drejtimi është duke shkuar dhe çfarë veprime duhet të ndërmarrë për ta mbajtur situatën nën kontroll. Sepse, në fund të fundit, qëllimi i të gjithëve duhet të jetë mbarëvajtja e rendit publik dhe ruajtja e paqes”, ka thënë Krasniqi.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se gjatë takimit nuk ka parë ndonjë plan

të qeverisë për zgjidhjen e gjendjes së re të krijuar dhe gatishmëri për bashkërendim të plotë me aleatët e vendit. “Për Lidhjen Demokratike të Kosovës ne besojmë se koordinimi i ngushtë me Departamentin Amerikan të Shtetit dhe me institucionet e sigurisë amerikane, me aleatët tanë në Uashington dhe Bruksel, është zgjidhja e vetme adekuate në situatën e tanishme që është Kosova. Kosova nuk duhet të bie pre e kurtheve të destabilizimit të vendit nga faktorë që burojnë në Beograd e në koordinime shumë më të thella sesa kaq, por që duhet të punojë ngushtë me aleatët e vet për paqe dhe stabilitet në territorin e vet”, ka theksuar Abdixhiku.

Ai ka thënë se në përballje të tilla është jetike që Kosova të bashkërendohet me aleatët e vet. “Pra një qeveri që i kërkon popullit të vet që të zgjedhë mes aleatëve historikë dhe ligjshmërisë ka bërë që në fillim gabim. Ne kërkojmë që Qeveri e

Kosovës të sigurojë edhe ligjshmëri edhe aleatët e vet”, ka deklaruar Abdixhiku.

Ndërkaq lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka lëshuar takimin me Kurtin sapo ka nisur. Haradinaj ka thënë nuk mund të rrinte në një takim që ishte vetëm ligjërata. “Edhe pse isha pjesë e takimit me kryeministrin Kurti, u detyrova ta lëshoj takimin sepse Kurti mbante ligjërata e nuk na sqaronte se përse i ka prishur raportet me Amerikën dhe se nuk po realizon kërkesën e saj. Për mua është e papranueshme që në raste kaq të ndjeshme t’i prishim raportet me aleatin kryesor të sigurisë”, ka thënë Haradinaj.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë shprehur shqetësime në lidhje me mundësinë e tensioneve në veri. ShBA-ja dhe BE-ja u kanë bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zgjedhin rrugën e bisedimeve dhe të përmbahen nga veprimet që do

të çonin në dhunë dhe përplasje. Dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik parlamentar Lista Serbe kanë dorëzuar të hënën dorëheqje të parevokueshme, ndërkaq 578 zyrtarë policorë të komunitetit serb kanë dhënë dorëheqje pasi Qeveria e Kosovës më 1 nëntor nisi ta zbatojë planin prej tri fazash për reregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia në ato RKS - Republika e Kosovës.

Zyrtarët e lartë të Listës Serbe, të cilët më 5 nëntor vendosën që të japin dorëheqje nga institucionet e Kosovës, nuk do të mbesin pa paga, sepse paralelisht me pagat e Kosovës ata marrin paga edhe nga buxheti i Serbisë. Ata kanë përfshirë pagat e marra nga Serbia gjatë deklarimit të pasurisë për vitin 2022 në Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës.

Sekretarit i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se ka folur me kryeministrin e

Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për “situatën e tensionuar në veri të Kosovës”. “U kërkova të dyve që të përmbahen nga çdo veprim i njëanshëm që mund të shkaktojë përshkallëzim. Dialogu është e vetmja rrugë përpara”, ka shkruar Stoltenbergu në “Twitter”. Ai ka theksuar se NATO dhe KFOR-i mbeten vigjilentë për situatën atje.

Në një njoftim për medie të lëshuar nga zyra e Kurtit, njoftohet se shefi i ekzekutivit i tha shefit të NATO-s se “bojkoti i ditëve të fundit është i nxitur dhe orkestruar nga Beogradi zyrtar dhe është rezultat i veprimeve të tyre të vazhdueshme destruktive në dialogun ndërmjet dy vendeve”.

Kurti e ka siguruar sekretarin Stoltenberg se qeveria dhe institucionet e Kosovës “si gjithmonë do të bashkëpunojnë, komunikojnë dhe bashkërenditen ngushtë me aleatët dhe partnerët e saj”.



Ish-ambasadori amerikan në Kosovë: Tensionet nuk erdhën për shkak të targave

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Thelbi i tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është te targat, ka thënë ish-ambasadori amerikan në Prishtinë, Greg Delawie. Ai ka thënë se ky tensionim ka ardhur për shkak të refuzimit të Serbisë për ta pranuar pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Delawie ka thënë se serbët

duhet të kthehen në institucionet e Kosovës prej të cilave janë larguar, ngaqë është në interesin e mirë të tyre. “Zyrtarët e minoritetit serb janë të kontrolluar nga Qeveria e Serbisë, siç është edhe pjesëmarrja e tyre në institucionet e Kosovës, në mënyrë që të kundërshtohet Qeveria e

Kosovës. Unë besoj në aftësinë dhe motivimin e qeverisë franceze dhe gjermane për të dalë me një nismë krijuese për të zgjidhur një nga pengesat më të rëndësishme që qëndrojnë në rrugën e paqes së vërtetë në Evropën Juglindore”, ka thënë ambasadori Greg Delawie për “Zërin e Amerikës”.



Përfshirja e xhudistëve në FSK

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, kryetari i Federatës së Xhudos, Agron Kuka, trajneri Driton

Kika, xhudistë e pjesëmarrës të tjerë, u takuan për të diskutuar rreth programit për integrimin e sportistëve dhe trajnerëve në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Një takim shumë konstruktiv

dhe diskutime përmbajtësore për mënyrën e funksionimit të këtij programi. Të gjitha palët u pajtuan që ta vazhdojnë angazhimin e tyre për ta vënë në zbatim këtë projekt afatgjatë.



Kosova dhe Franca, marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Delegacioni i prirë nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, gjatë qëndrimit të tij në Francë, u takua me ministrin e Transformimit dhe Shërbimit Publik të Republikës së Francës, Stanislas Guerini dhe ekipin e tij. Profesionalizimi dhe modernizimi i administratës publike, tërheqja e talenteve, arsimimi dhe trajnimet në fushën e administratës publike ishin temat e diskutimit mes zëvendësministrit Dobra me ministrin Guerini.

Nga ky takim u kuptua se të dyja shtetet përballen me sfida të ngjashme dhe se reformat që të dyja qeveritë janë duke ndërmarrë për t'i transformuar administratat respektive kanë ngjashmëri të mëdha dhe se bazohen në parime të pranuar si të mirëqena në botën demokratike si: meritokracia, besimi i qytetarëve në institucione, depolitizimi i

administratës, mundësi të barabarta për të gjithë, mobilitet përbrenda administratës dhe bashkëpunim me sektorin privat, administratë efikase, shërbime publike kualitative për të gjithë qytetarët.

Ministri Guerini konfirmoi edhe një herë se ministria që drejton dhe institucionet vartëse si: Institut National du Service Public (ish-École nationale d'administration) janë të gatshme ta përkrahin Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës në zbatimin e reformës ambicioze, të nevojshme e të kërkuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës, reformë që në pikat kyçe është e ngjashme me atë që Republika franceze është duke bërë.

Duke marrë parasysh vullnetin e përbashkët për të bashkëpunuar dhe këmbyer praktikat më të mira, për ta mbështetur njëri-tjetrin në mënyrë që reformat të jenë të suksesshme, të dyja palët



nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, e cila fokusohet në fuqizimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e proceseve të rekrutimit dhe

proceseve të tjera administrative, si dhe trajnimet në fushën e administratës publike.

Me këtë rast zëvendësministri Dobra dhe ministri Guerini

shprehën gatishmërinë që bashkëpunimi mes dy vendeve të thellohet edhe më tutje me takime të shpeshta të nivelit politik dhe profesional.

Shkolla Teknike "Fan S. Noli" në Podujevë furnizohet me kabinete



PODUJEVË, 8 NËNTOR - Në ShMLT "Fan S. Noli" është bërë inaugurimi i kabineteve për lëndët Energjetikë dhe Instalim Elektrik, Automekanikë, Ngrohje dhe Klimatizim. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim në mes të komunës së Podujevës dhe Ambasadës së Japonisë në Kosovë.

Në këtë ceremoni morën pjesë ambasadori jorezident i Japonisë në Kosovë, Akira Mizutani, nënkryetarja e komunës Marigona Lahu, zëvendësministri i MASHT-it, Dukagjin Pupovci, drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, drejtori i shkollës teknike, Fatmir Emini, mësimdhënës e nxënës të kësaj shkolle.

Vlera totale e projektit është 46 667 euro, ku komuna participon

me 8 667, ndërsa ambasada me 38 mijë euro.

Nënkryetarja Lahu në fjalën e saj para të pranishmëve e falënderoi ambasadorin Mizutani dhe popullin japonez për ndihmën e ofruar nga ambasada për komunën e Podujevës. Ajo tha se këto kabinete do të ndihmojnë shumë që nxënësit e kësaj shkolle mësimin teorik ta lidhin me atë praktik, e që do të ndikojë drejtpërdrejt në avancimin e tyre profesional.

Ambasadori Mizutani tha se ndihet shumë i lumtur që kanë arritur ta realizojnë këtë projekt në komunën e Podujevës dhe u zotua se bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me komunën do të vazhdojë edhe në të ardhmen për realizimin e projekteve të tjera, veçmas në fushën e arsimit.

Nura dhe Lushtaku vizitojnë Stacionin Policor të Skenderajt

SKENDERAJ, 8 NËNTOR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe nënkryetari Sami Lushtaku, kanë vizituar stacionin policor në këtë komunë. Ata janë pritur nga komandanti Muhamet Kajtazi dhe stafi i tij policor.

Në takim është diskutuar për situatën e përgjithshme të

sigurisë brenda territorit të komunës, përfshirë fshatrat Bajë e Syriganë, e cila u vlerësua e qetë.

Kryetari Nura ka ripërsëritur gatishmërinë për të ofruar në çdo kohë bashkëpunimin me Policinë e Kosovës në të mirë të interesit të qytetarëve dhe në funksion të sigurisë publike.

Ky takim vjen si rezultat i zhvillimeve të fundit në veriun e Kosovës, ku përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës nga komuniteti serb dhanë dorëheqje nga përgjegjësia institucionale dhe organet shtetërore në shenjë pakënaqësie për mosrealizimin e kërkesave nga Qeveria e Kosovës.



Gjykata liron nga akuza katër ish-ministra të Qeverisë së Kosovës

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Katër ish-ministra të Qeverisë së Kosovës janë liruar nga akuza për "keqpërdorim të detyrës zyrtare" në rastin e njohur si "Afera e Hidrocentraleve".

Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar nga akuza ish-ministrat: Mimoza Kusari-Lila, Nenad Rashedi, Besim Beqaj dhe Dardan Gashi.

Shpallja e aktgjykimit për këtë rast është bërë të martën nga kryetari i trupit gjykues Valon Kurtaj. "[Ata] janë liruar nga akuza, pasi që gjykata nuk ka gjetur prova se të njëjtët kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e Gjykatës Themelore më 8 nëntor.

Në prill të vitit 2020 Prokuroria kishte ngritur aktakuzë kundër 19 personave, përfshirë edhe ish-ministrat e qeverisë, që në atë kohë udhëhiqej nga ish-

kryeministri Hashim Thaçi. Ata ishin anëtarë të Komitetit Qeveritar për Privatizim dhe akuza që rëndonte mbi ta ishte se në cilësi të personave zyrtarë kanë tejkaluar kompetencat e tyre në këtë komision.

Sipas aktakuzës, ata njëzëri kishin votuar që hidrocentralet të cilat prodhojnë energji elektrike si: hidrocentrali i Lumbardhit, hidrocentrali në Burim, hidrocentrali i Radavcit dhe hidrocentrali "Dikance" të transferohen te Kompania Kosovare e Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KKDFE) dhe më pas të privatizohen nga kompania "Limak-Calik". "Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve është përmbyllur procesi i privatizimit të KKDFE-së, përkundër faktit se të njëjtat nuk është dashur të transferohen dhe privatizohen, për arsye se një veprim të tillë e ndalon baza ligjore", thuhet në njoftimin për aktakuzë të vitit



2020.

Sipas organit të akuzës, dëmi tjetër i shkaktuar nga personat e akuzuar është vlera e investuar (shtuar) në hidrocentrale prej

12,628,166.41 eurosh, që nuk përfshin vlerën e aseteve para koncesionit sepse, sipas prokurorisë, KEK-u nuk ka bërë regjistrimin dhe nuk ka

paraqitur vlerën e aseteve para privatizimit. "Ky dëm edhe më tutje vazhdon të shkaktohet në mënyrë të përhershme", kishte vlerësuar Prokuroria Speciale.

Abonimi njëvjeçar në parkingun nëntokësor të Prishtinës pritet të jetë 2 500 euro



PRISHTINË, 8 NËNTOR - Parkingu Nëntokësor i Prishtinës është drejt përfundimit dhe pritet të

hapet shpejt. Ndonëse ka 600 vendparkingje në dy kate, abonimi vjetor në këtë

vendparking do të kushtojë 2 500 euro.

Një orë qëndrim në këtë parking

është 1 euro, përderisa pas orës së katërt të qëndrimit çmimi do të jetë 0.80 centë. Qëndrimi nga 12

deri në 24 orë është 15 euro, abonimi javor 90 euro, muajor 250 euro, për gjashtë muaj 1 350 euro. Çmimet e parkingut nëntokësor, sipas komunës, është harmonizuar me ato të "Prishtina Parking". Çmimet e parkingut nëntokësor, sipas komunës së Prishtinës, është harmonizuar me ato të "Prishtina Parking".

Drejtoresha e Planifikimit Strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm në komunën e Prishtinës, Mimoza Sylejmani, ka thënë se ky parking është i ndërtuar me standardet e fundit evropiane. "Po ashtu edhe pjesa e lokaleve, plateja dhe drunjtë që janë duke u mbjellë janë drejt fundit. Në këtë muaj do ta kemi të gatshëm. Kontrata është e planifikuar të përfundojë më 10 nëntor. Në fakt, gjithçka është në përfundim", ka theksuar Sylejmani.

Ky parking do të ketë 78 kamera të vendosura për mbikëqyrje, shtatë hyrje-dalje për këmbësorë, mbushës elektrikë për vetura, lifte dhe mundësi hyrje-daljeje për personat me nevojë të veçanta.

Anëtarët e kuvendeve të komunave mbajnë punëtori për nivelin lokal

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave ka nisur punëtorinë për anëtarët e kuvendeve të komunave, në të cilën është duke trajtuar tema nga manuali "Komunat gjithëpërfshirëse". Këto punëtori me anëtarët e kuvendeve të komunave janë

duke trajtuar tema të ndryshme rreth gjithëpërfshirjes në nivelin lokal, me theks të veçantë të grupeve të cënueshme dhe si të krijohen praktika të mira të gjithëpërfshirjes në politikëbërjen lokale. Punëtoritë e kësaj natyre janë

shumë të rëndësishme sepse krijojnë shkëmbim të përvojave të politikave gjithëpërfshirëse në mes të komunave dhe anëtarët e kuvendeve mund të jenë palë me shumë rëndësi për hartimin dhe implementimin e politikave gjithëpërfshirëse.



Zgjatjen edhe për 30 ditë masat emergjente të energjisë elektrike

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Me 65 vota për është votuar vendimi i Qeverisë së Kosovës për zgjatjen për 30 ditë të masave emergjente të energjisë elektrike. Për këtë vendim është zhvilluar të martën seancë e jashtëzakonshme. Ministri e Ekonomisë, Artanë Rizvanolli, gjatë seancës së

Kuvendit të Kosovës, ka kërkuar që të miratohen për 30 ditë masat për menaxhimin e krizës energjetike. "Gjatë verës disa njësi të termocentraleve kanë qenë në remont total e që nuk kanë mundur ta mbulojnë tërësisht kërkesën e energjisë elektrike. Situata që nga ajo kohë ka shkuar duke u

përkeqësuar dhe do të vazhdojë të mbetet e ndjeshme", ka thënë Rizvanolli. Kurse deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka deklaruar se qeveria Kurti po e keqpërdor çështjen për shpalljen e masave emergjente për energjinë elektrike.



KEK-u: Ngrehet siguria e operimeve në njësitë prodhuese

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) njofton se njësi B2 e termocentralit "Kosova B" ka filluar revizionin e rregullt vjetor deri më 15 nëntor.

Sipas KEK-ut, gjatë kësaj periudhe do të operohet me njësitë A3, A4 dhe B1. "Korporata Energjetike e Kosovës njofton opinionin se, bazuar në Bilancin Vjetor Elektro-Energjetik (BVEE), dhe me qëllim të ngritjes së sigurisë së operimeve dhe stabilitetit të njërive gjeneruese gjatë periudhës së dimrit, njësi B-2 e termocentralit Kosova B ka filluar revizionin e rregullt vjetor (tetëditor) nga sot deri me datën 15.11.2022", ka njoftuar KEK-u. Gjatë kësaj periudhe, po sipas BVEE-së, KEK-u do të operojë me njësitë A3=125 MW/h, dhe B1=250MW/h. "Gjithashtu, nga njësi B1 do të furnizohet edhe 'Termokosi' me rreth 45-50 MW/h energji termike, varësisht nga kërkesa e 'Termokos'-it", ka theksuar KEK-u.



Mbi 60 mijë vizitorë në hotelet e Kosovës gjatë gushtit, shumica të huaj

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Afër 61 mijë persona i kanë vizituar hotelet e Kosovës gjatë muajit gusht të këtij viti, shumica prej të tyre shtetas të huaj, ka njoftuar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), e cila këtë të martë ka publikuar Statistikat e Hotelierisë në Kosovë për muajin gusht 2022.

Pjesë e anketës thuhet se ishin 209 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. "Numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) në këtë muaj ishte 60 952, prej tyre 29.50 për qind ishin vendorë dhe 70.50 për qind të jashtëm, ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 121 478, prej tyre 32.13 për qind nga vendorët dhe 67.87 për qind nga të huajt", thuhet në statistikën e ASK-së. Numrin më të madh të



vizitorëve e kishte rajoni i Prishtinës me 20 548 vizitorë, ndërsa numrin më të madh të netqëndrimeve e kishte rajoni i Pejës me 51 270 netqëndrime. Numri më i madh i vizitorëve të

huaj përqendrohet në Prishtinë, Pejë, Prizren e kështu me radhë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh ishte nga Gjermania, Shqipëri, Zvicra etj.




Kurti dhe Hykolli diskutojnë për avancimin e të drejtave të punëtorëve

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atthe Hykolli. Në kuadër të komunikimit të rregullt,

kryeministri Kurti dhe Hykolli në këtë takim kanë diskutuar për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet qeverisë dhe BSPK-së për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat.

Universi është një Hologram



Universi është një hologram dhe gjithcka që ju shihni në të, përfshirë edhe këtë artikull që lexoni, është pjesë e një projekcioni të thjeshtë. Në vitin 1997, fizikanti Juan Maldacena publikoi teorinë e tij, sipas të cilës ajo që ne shohim, që nga objektet që kemi pranë e deri tek trupat qiellorë miliona kilometra larg, janë një hologram 3D i një universi tjetër 2D.

Deri më tani, kjo teori nuk ishte

testuar kurrë matematikisht. Por së fundmi, modelet studiuere të saj sugjerojnë se hipoteza kurajoze e Maldacena-s mund të jetë e vërtetë. Sipas kësaj teorie, graviteti në univers ekziston falë valëve lëkundëse në hapësirë, që nga ana e tyre janë holograme të ndodhive dhe ngjarjeve që ndodhin në një tjetër kozmos të sheshtë.

Modeli i profesorit Maldacena sugjeron se universi ekziston në 9


dimensione në hapësirë dhe një në kohë. Kur ka kaluar më shumë se 2 dekada e gjysmë nga hedhja e kësaj teorie, studiuesit japonezë u përpoqën ta zbatojnë atë në kushte laboratorike, duke siguruar të dhëna matematikore që sugjerojnë se parimi holografik i ndërtimit të universit tonë, mund të jetë i vërtetë.

Ky parim thotë se ekziston një sipërfaqe 2 dimensionale që nevojitet për të përshkruar një

objekt 3 dimensional. Sipërfaqja 2 dimensionale, gjithnjë sipas kësaj teorie, është një tjetër univers, ndërsa ajo 3 dimensionale është universi ynë, gjithë ajo cka ne shohim. Maldacena përforcon teorinë e tij duke pretenduar se të dhënat që përmbajnë përshkrimin e masës në hapësirë, si njeriu apo kometa, mund të 'strehohen' në zona të caktuara të universit të sheshtë.

Këto zona, thotë fizikanti, janë

“Vrimat e zeza”. Në këto pjesë të universit, shkencëtari thotë se të gjitha objektet që bien në to, ‘ruhen’ si një kujtim të dhënash, jo si objekte fizike që vërtet ekzistojnë. Me pak fjalë, i gjithë universi ynë mund të shihet si një “strukturë 2 dimensionale e projektuar në hapësirë”, ose më thjeshtë akoma, “universi në të cilin ne besojmë se jetojmë, është një projekcion 3D i një universi tjetër 2D”. / Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova, bindëse ndaj Gjibraltarit

Prishtinë, 8 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave ka shënuar fitore në hapje të kualifikimeve për Kampionatin Evropian në Ligën B, duke mposhtur Gjibraltarin, me rezultat 7:0, në stadiumin "Fadil Vokrri". "Dardanet" e morën situatën në duar që nga fillimi i ndeshjes dhe dominuan plotësisht lojën në të dy pjesët. Flondra Behrami u përkujdes t'ia siguroj epërsinë Kosovës në minutën e 5-të. E njëjta futbolliste e tundi sërish portën e mysafireve, në minutën e 18-të, pasi finalizoi pasimin nga Albulena Guri. Kjo e fundit konkretizoi një rast në minutën e 26-të duke e ngritur rezultatin në 3:0, në të mirë të Kosovës. Albulena Guri shënoi sërish tre minuta para se të përfundonte

pjesa e parë, e cila u përmyll me rezultat 4:0. Dardanet vazhduan me paraqitje fantastike edhe në pjesën e dytë, ku shënuan edhe tre gola tjerë. Golin e radhës Kosova e gjeti nga një penallti e akorduar në minutën e 49-të. Elma Kadriu ishte e saktë në gjuajtjen e saj, duke e ngritur epërsinë në 5:0. Gjashtë minuta para se të përfundojë takimi, Erisa Popaj shtoi epërsinë në 6:0, derisa rezultatin përfundimtar e vendosi Vesa Paqarizi. Ndeshjen e radhës Kosova e luan kundër Bullgarisë, me 14 nëntor, nga ora 13:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Kosova ndaj Gjibraltarit luajti me këtë përbërje: Alma Demiri, Vanesa Nushi, Gresa Berisha, Kreshnike Ramaja, Melisa Berisha, Erletë Shabiu, Vesa Paqarizi, Elma Kadriu, Rreze Gashi, Flondra Behrami dhe Albulena Guri.



Kosova synon ta befasojë Ukrainën

Prishtinë, 8 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në futsal po përgatitet për ndeshjen e tretë në kuadër të fazës "Main Round" për kualifikimet e Botërorit 2024 kundër Ukrainës. Kjo ndeshje zhvillohet të mërkurën në orën 17:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, ndërsa hyrja për tifozët është falas. Pas dy seancave stërvitore në palestrën e Obiliqit, "Dardanet" e futsalit të hënën kanë vazhduar punën në palestrën ku edhe do të zhvillohet ndeshja. Gjatë stërvitjes përzgjedhësi Arben Simitçiu ka punuar në aspektin tekniko-taktik si dhe për shmangien e gabimeve të shfaqura në ndeshjen e parë kundër ukrainasve. Atmosfera në ekipin përfaqësues para kësaj përballjeje



është mjaft pozitive dhe të gjithë shpresojnë se me mbështetjen e tifozëve do të arrijnë ta shijojnë fitoren e parë e cila do t'i mbante gjallë shpresat për kualifikim tutje. "Realisht pres fitore dhe do të bëjmë çmos për t'ia arritur qëllimit. Ushtrimet po shkojnë shumë mirë dhe djemtë janë në formë të mirë. Ka kohë që synojmë ta bëjmë një befasi të madhe dhe shpresoj që ka ardhur koha për ta arritur këtë. E kemi bërë videoanalizën e ndeshjes me Ukrainën dhe nëse s'i përsërisim gabimet që na kushtuan në ndeshjen e parë, besoj se do t'i befasojmë. Ekipi është komplet për momentin dhe besoj se edhe në ndeshje do të jemi të kompletuar. Dardanet dhe tërë tifozët i ftoj që të


na mbështesin në sallë, por edhe nga shtëpitë e tyre, sepse ajo energji pozitive e rrit performancën e ekipit", ka thënë Simitçiu. Kosova deri tash i ka zhvilluar dy ndeshje në kuadër të këtyre kualifikimeve dhe të dyja si mysafire, ku ka pësuar humbje me rezultat të ngushtë. Lojtari Endrit Hajdini beson se ndeshja e parë para tifozëve dardanë do t'u sjellë atyre fat. "Jemi përgatitur maksimalisht dhe ekipi është i kompletuar. Meqenëse loja luhet në Prishtinë, besoj në përkrahje të fuqishme të tifozëve. Shpresojmë në fitore, ngaqë e njohim kundërshtarin dhe e kemi analizuar mirë ndeshjen e parë", ka deklaruar Hajdini.

Derbi i Anamoravës zhvillohet përsëri pa tifozë

Gjilan, 8 nëntor - Klubi i Gjilanit ka njoftuar sot për duelin me rivalen e qytetit, Dritën, që do të zhvillohet të enjten në kuadër të xhiros së 16 në Superligën e Kosovës. Në njoftimin e klubit të Gjilanit bëhet me dije se Derbi i Anamoravës do të zhvillohet pa tifozë. "Për shkak të kushteve jo të

favorshme dhe mungesës së tribunave, takimi do të zhvillohet pa praninë e tifozëve dhe qëndrimi afër stadiumit do të jetë i ndaluar për shikues", thuhet në njoftimin e SC Gjilanit. Kjo është hera e dytë këtë sezon që në derbin më të madh në Kosovë do të mungojnë tifozët "Skifterat"

dhe "Intelektualët". Ndeshja në mes të Gjilanit dhe Dritës do të zhvillohet më 10 nëntor (e enjte) në stadiumin ndihmës me bari sintetik në Gjilan. Drita aktualisht është lidere e Superligës me 31 pikë të mbledhura, tetë më shumë se Gjilani që renditet i katërti në tabelë.



Besa Famgas mëson kundërshtarin e Kupës Evropiane

PRISHTINË, 8 NËNTOR - KH Besa Famgas do të udhëtojë në Kroaci për ndeshjen e parë të raundit të tretë të Kupës Evropiane për

Hendbollistë. Kundërshtar i Besës së Pejës është ekipi kroat MRK Sesvete. Shorti për raundin e tretë është tërhequr të martën në

Vjenë. Ndeshja e parë luhet në Kroaci në fundjavën e parë të dhjetorit, ndërsa e kthimit në Pejë në fundjavën e dytë të

dhjetorit. Në raundin e dytë Besa Famgas e kaloi Helsinkin. Synim i Besës do të jetë kalimi edhe i skuadrës kroate.



Sejdiu emërohet trajner në skuadrën e Ligës së Parë

Pejë, 8 nëntor - Gani Sejdiu është emëruar trajneri i Phoenixit. Klubi nga Banja e Pejës ka bërë me dije për arritjen e marrëveshjes me trajnerin nga Mitrovica, i cili së fundmi udhëhoqi Vëllaznimit.

Sejdiu gjatë karrierës së tij ka drejtuar edhe Trepçën '89, Trepçën, Vushtrinë, Feronikelin, Besën, Ballkanin dhe Renovën e Maqedonisë së Veriut. "Ju njoftojmë që në sezonin e ardhshëm drejtimin e

skuadrës sonë e merr trajneri i mirënjohur Gani Sejdiu. Klubi ynë gjithë punën dhe përpjekjet për inkuadrimin në elitën e futbollit kosovar ia beson trajnerit Gani Sejdiu i cili bart në vete trofe të shumta të

fituara nëpër klube të mëdha kosovare. Kryesia e klubit si dhe ekipi i lojtarëve e mirëpresin dhe i urojnë mirëseardhje trajnerit. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e FC Phoenix-Banjë.



Munishi po i inkuadron në ekipin e parë talentët nga ekipi i juniorëve

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Krahas punës së madhe që po bëhet në ekipin e parë, pa u fshehur nga synimi për rezultate maksimale, kryetrajneri i ekipit, Ismet Munishi, po mendon edhe për lojtarët e ekipeve zinxhirë. Në 14-t ndeshjet e zhvilluara deri më tash Munishi dhe pjesa tjetër e stafit të trajnerëve, Debatik Curri, Armend Simnica e Ahmet Beselica, i kanë përfshirë në listën e ngushtë për ndeshje disa lojtarë të rinj e me shumë talent që vijnë nga ekipi i juniorëve që drejtohet nga Agim Maliqi. "Sulmuesi 17-vjeçar Iqball Jashari ishte në protokoll dhe gati për lojë ndaj Trepçës '89 sikurse portieri Butrint Bulliqi (19-vjeçar) ishte në bankë ndaj Malishevës. Një tjetër lojtar premtues është edhe Korab Luma, i përfshirë për takimin ndaj Dukagjinit dhe gati për 'aksion'. Edhe Luma është 17-vjeçar. Mbrojtësi Andi



Salihu (19) ishte në bankinë për ndeshjen e fundit ndaj SC Gjilanit. Edhe mbrojtësi i ri Ardi Ajdini (20) është përfshirë në disa ndeshje. Një tjetër lojtar premtues është edhe Endit Baholli (22) i ardhur nga 2 Korriku, i cili tashmë ka debutuar me ekipin. "Portier i dytë të 'bardhekaltrit' është 22-vjeçari Egzon Beslimi, të cilit

sigurisht se do t'i jepet mundësia", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Trajneri Munishi ka premtuar edhe ardhje të reja nga ekipi i juniorëve, por edhe nga klubet e tjera e shkollat e futbollit në vend. FC Prishtina po punon edhe për disa projekte për talentët e rinj të cilët do të zbulohen së shpejti.

Milwaukee humbet, Utah Jazzi turpëron lakersat

MILWAUKEE, 8 NËNTOR - Pas nëntë fitoresh vjen humbja e parë në kampionat për skuadrën e Milwaukee Bucksit, që u mund me rezultat 117-98 nga Atlanta. Vendimtar ishte stoli i skuadrës vendase, nga erdhën 59 pikë, ndërsa për Bucksin u dallua Antetokounmpo me 25 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen e parë sezonale. Fitore në sekondat e fundit korri edhe



skuadra e clippersave, që ndali Cavaliersin pas tetë fitoresh radhazi. Kalifornianët fituan me shifrat 119-117, ndeshje ku gjashtë lojtarë të clippersave (të gjithë titullarët) realizuan mbi 10 pikë. Për cavaliersat shkëlqeu Mobley me 26 pikë, por që mbetën për statistikë, raporton "Telesport". Bostoni, falë 39

pikëve të Tatumit, mposhti Memphisin (109-106) jashtë fushës, ndërsa Philadelphia triumfoi me rezultat 100-88 ndaj Phoenixit, ndeshje ku dallimin e bëri Joel Embiid me 33 pikë e 10 rebounde. Utah Jazzi i turpëroi lakersit, duke fituar 139-116, takim ku 7 lojtarë të Jazzit realizuan mbi 10 pikë.

SHKURT

Muriqi në formacionin e javës në La Liga

Vedat Muriqi po vazhdon të shkëlqejë në elitën e futbollit spanjoll me Mallorcan. Muriqi shënoi ndaj Villarrealit, duke shtuar edhe një asistim. Ai me këtë gol ka arritur në shifrën e 7 golave, nga 11 ndeshje sa i ka shënuar në total skuadra e Mallorcas në La Liga. Sulmuesi "dardan" pas kësaj paraqitjeje fantastike është përzgjedhur në formacionin e javës, duke u notuar me notën 8.4.

Formacionet: Badia, Gudelj, Lopez, Gonzalez, Avila, Roque, De Jong, Alba, Aspas, Asensio, Muriqi.

Neueri: Ky mund të jetë Botërori im i fundit

Portieri dhe kapiteni i Gjermanisë, Manuel Neuer, thotë se Botërori i fundit në Katar mund të jetë ndoshta i fundit për të. Në moshën 36-vjeçare, numri një i kombëtares së "pancerave" mendon seriozisht t'i varë dorezat në gozhdë për t'i hapur rrugën brezit të ri. "Nuk i dihet kurrë, por mendoj se do të jetë Botërori im i fundit", ka deklaruar gardiani i Bayern Munchenit. Katër herë kampionët e botës janë mes pretendenteve për të triumfuar në turneun e parë që do të mbahet në dimër, por Neuer tregohet i kujdesshëm: "Unë nuk kam frikë të them se ne duam të shpallemi kampionë bote, por kemi nevojë për momentin e duhur. E dimë që do të ketë shumë rivale të forta".

Ancelotti: Jemi të zhgënjyer me humbjen

Reali i Madridit pësoi një humbje befasuese nga Rayo Vallecano (3-2). Pas ndeshjes trajneri Carlo Ancelotti është shprehur i zhgënjyer. "Kemi bërë gabime. Na mungonte forca që kishte kundërshtari. Nuk mjaftoi për ta barazuar ndeshjen, kishim një nivel më të ulët se ata. A kemi humbur se djemtë e kanë mendjen te Kupa e Botës? Unë nuk mendoj se është kjo. Ne nuk jemi të freskët sepse kemi luajtur kaq shumë ndeshje. Nuk kemi qenë të freskët, nuk jemi aq mirë si më parë, por është normale, kampionati është shumë i gjatë", ka thënë Ancelotti. "Vinicius? Ai ka humbur shumë duele. Ishte një ndeshje e vështirë për të dhe për të gjithë. Gjithmonë ka bërë paraqitje të shkëlqyera, vetëm sot nuk ka pasur nivelin e herëve të tjera. Jam i zhgënjyer. Pjesa e parë e sezonit shkoi shumë mirë, më mirë se kurrë. Nuk jam i zhgënjyer me ekipin, por me karakteristikat. Kemi humbur forcën, nëse nuk i përgjigjesh intensitetit, cilësia teknike nuk mjafton", është shtuar Ancelotti.

Zaha pritet t'i bashkohet Barcelonës

Barcelona është duke studiuar me kujdes një mundësi për ta transferuar me parametra zero anësorin e Crystal Palace, Wilfried Zaha, kontrata e të cilit skadon në fund të sezonit. Barcelona shquhet për këto transferime me zero kosto, ku Eric Garcia, Depay, Kessie apo Christensen ishin një ndër ta. Zaha është 29 vjeç dhe përshtatet shumë mirë me skemën e Barcelonës. Ai është një anësor i gjithanshëm dhe shumë i shpejtë.

REZULTATET

Charlotte - Washington	100-108
Orlando - Houston	127-134
Detroit - Oklahoma	112-103
Indiana - New Orleans	129-122
Philadelphia - Phoenix	100-88
Atlanta - Milwaukee	117-98
Miami - Portland	107-110
Chicago - Toronto	111-97
Memphis - Boston	106-109
Minnesota - New York	107-120
San Antonio - Denver	109-115
Dallas - Brooklyn	96-94
Golden State - Sacramento	116-113
Utah Jazz - Lakers	139-116
Clippers - Cleveland	119-117

Verstappeni kundër garave sprint: Të gjithë garojmë me frikë për një arsye

Kampioni i botës në Formula 1, Max Verstappen, ka dalë kundër garave sprint që kanë hyrë në kalendarin e garave në dy sezonet e fundit. Këtë të shtunë, në pistën

e Interlagos, në Brazil, do të zhvillohet gara e tretë sprint e këtij sezoni, ndërkohë që duke nisur nga viti tjetër, do të jenë 6 të tilla. "Janë gara që nuk më pëlqejnë. Sa herë që zhvilloj një garë të tillë

përpiqem të mos pësoj dëme në makinën time për të dielën dhe jo të fitoj. E përsëris, synoj vetëm të mos kem ndonjë aksident, pasi do të kishte pasoja për garën e së dielës. Kjo vlen për të gjithë", ka

thënë Verstappeni. "Kemi pasur mjaft gara emocionuese përgjatë sezonit, ndaj nuk kemi nevojë për një garë që zgjat vetëm 30 minuta. Nëse të shtunën duhet të duelon për

vendin e tretë dhe ke një problem, përfundon në fund dhe do ta vuash këtë gjë ditën e diel. Ndaj, e konsideroj si një garë kurth, ku duhet të ruhesh", ka deklaruar Verstappeni.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 29.08.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 09.11.2022 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Një (1) Inkasant/Arkëtar -Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bënë zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara ;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të dretpërdrejtë;

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 09.11.2022 deri më datën 23.11.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Aga Rent" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811555210 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Aga Rent" D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811555210 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Aga Rent" L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811555210 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ermal Maloku, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Blerta Sinani shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit drejtimi Infermieri të Kolegjit AAB- Prishtinë.

- Blerta Sinani shpall të pavlefshme tri dëftesat dhe Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- Lumturije Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Borë Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M "Selman Riza", nga klasa e -I- deri -VIII-, Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -IX- të SH.M.T "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

